



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:078322
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05597422

C.nr.741/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses B.Ç. nga Komuna Pejë, të cilën e përfaqëson Fatmir Ademaj, avokat nga Peja, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “EUROSIG”, me seli në Prishtinë, Rr.“2 Korriku” nr. 4, me bazë juridike kompensim dëmi sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 6315.99 euro, jashtë seance me datën 19.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditëses B.Ç. nga Komuna Pejë, e parashtruar me datë 11.03.2024, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “EUROSIG me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 6315.99 euro.

II. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësja B.Ç. nga Komuna Pejë, përmes të autorizuarit të saj, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “EUROSIG me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim dëmi sipas autopërgjegjesisë, vlera e kontestit 6315.99 euro.

Gjykata, me datën 02.04.2024, ka pranuar parashtresën e paditëses, me anë të së cilës parashtresë, e njëjta ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës me arsyetim se paditësja e ka realizuar interesin juridik në procedurë jashtëgjyqësore duke lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me këtu të paditurën Kompania e Sigurimeve “EUROSIG”.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”*,

andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.741/24, me datë 19.04.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.

Numri i lëndës: 2024:078322
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05597422